

I dashur prind,

I kemi dhënë fëmijës suaj një kopje të dokumentit "Standardet e masave disiplinore dhe të ndërhyrjes për gjithë qytetin" (Kodi Disiplinor), botim i vitit 2006, si dhe dy (2) kopje të "Kontratës së sjelljes" ku parashtrihen përmbledhtas mënyrat si duhet të silllet fëmija në mjediset shkollore.

Kodi Disiplinor dhe Kontrata e Sjelljes janë dy pjesë përbërëse të përpjekjeve tona të vazhdueshme për ta mbajtur mjedisin shkollor të sigurt dhe inkurajues për të gjithë nxënësit. Ka rëndësi të madhe që të gjithë nxënësit të kuptojnë rregullat e shkollës dhe kërkesat e sjelljes. Për këtë arsye, e vlerësojmë shumë bashkëpunimin tuaj për t'i lexuar dhe për t'i diskutuar këto dokumente me fëmijën/fëmijët tuaj.

Pasi të keni biseduar me fëmijën, edhe ju edhe fëmija duhet të nënshkruani një kopje të kontratës së sjelljes, të cilën pastaj fëmija duhet ta sjellë në shkollë e t'ia dorëzojë mësuesit. Kopjen tjetër, së bashku me Kodin Disiplinor, mund ta mbani ju.

Nëse keni ndonjë pyetje, telefonojini shkollës në numrin _____.

Ju falënderojmë që na ndihmoni t'i bëjmë shkollat tona më të mira, më të forta dhe më të sigurta për fëmijën/fëmijët tuaj.

Sinqerisht juaji/juaja,

Drejtori/Drejtoresha